ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

BROSHURË INFORMUESE

Ligji për NJOFTIMIN dhe KONSULTIMIN publik

FONDACIONI SHOQËRIA
E HAPUR PËR SHQIPËRINË

Kjo broshurë ka për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të grupeve të interesit dhe publikut të gjerë, për të nxitur pjesëmarrjen në proceset vendimmarrëse dhe politikëbërëse, në frymën e ligjit 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik". Broshura nuk është një komentar zyrtar i ligjit, por është një material orientues, i formuluar me një gjuhë të thjeshtë, e cila besojmë se do t'i vijë në ndihmë, së pari grupeve të interesit, por gjithashtu edhe organeve publike që ndërmarrin nisma për hartimin e projektakteve.

Ky publikim realizohet në kuadër të projektit "Për një transparencë dhe pjesëmarrje më të lartë të grupeve të interesit në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse të organeve publike" të mbështetur financiarisht nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

FONDACIONI SHOQËRIA
E HAPUR PËR SHQIPËRINË

Mendimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit.

Për më shumë informacion për ligjin nr. 146/2014 ose nëse keni nevojë për asistencë në ushtrimin e së drejtës për t'u konsultuar lidhur me projektaktet na kontaktoni në adresat tona si vijon:

Komiteti Shqiptar i Helsinkit
Tel./Fax: +355 4 22 33 671
Mobile: +355 68 20 23 699 / +355 69 40 75 732
https://www.facebook.com/KomitetiShqiptarIHelsinkit
E-mail: office@ahc.org.al
www.ahc.org.al

Përse lindi nevoja për miratimin e këtij ligji?

Në kuadër të pjesëmarrjes në nismën ndërkombëtare vullnetare "Partneritet për Qeverisje të Hapur", shteti ynë ka ndërmarrë angazhim ndaj qytetarëve për të promovuar transparencën, fuqizimin e qytetarëve, luftën ndaj korrupsionit dhe për të shfrytëzuar teknologjitë e reja për forcimin e qeverisjes.

Nevoja për miratimin e këtij ligji lindi edhe si rezultat i problematikave që kishin shoqëruar konsultimin publik për nisma të rëndësishme ligjore ose politika apo strategji me interes publik, i cili shpesh herë bëhej në mënyrë formale ose me afate tepër të ngushta që nuk mundësonin dhënien e sugjerimeve apo mendimeve cilësore dhe të studiuara nga shoqëria civile apo grupe të tjera interesi.

Rrjedhojë e këtij angazhimi të shtetit dhe problematikave që kishin shoqëruar procesin e njoftimit dhe konsultimit publik, ishte miratimi në Tetor të vitit 2014 nga Kuvendi i Shqipërisë i ligjit Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik". Fondacion për Shoqërinë e Hapur për Shqipërinë dhe të aktorë të tjerë të shoqërisë civile nxitën miratimin e këtij ligji dhe kontribuuan gjatë hartimit dhe konsultimit të tij.

Cila është rëndësia e konsultimit publik?

Procesi i konsultimit me publikun mundëson që një numër i madh personash dhe institucionesh të kontribuojnë në përgatitjen e legjislacionit, strategjive ose politikave me interes publik dhe krijon gjithashtu, mundësinë për t'u njohur me mendimet dhe sugjerimet e tyre nga organet publike që hartojnë këto projekte.

Konsultimi e bën dialogun efektiv dhe përmirëson politikat dhe përmbajtjen e akteve ligjore. Një nga arsyet kryesore pse synohet një shkallë më e lartë konsultimi në procesin legjislativ dhe atë vendimmarrës është nevoja për të siguruar pranim më të gjerë të legjislacionit, strategjive dhe politikave dhe, për rrjedhojë, edhe lehtësim në zbatimin e tyre.

Çfarë rregullon ligji për njoftimin dhe konsultimin publik?

Ligji rregullon marrëdhëniet për realizimin e procesit të konsultimit publik, në vendimmarrjet që i përkasin hartimit të projektakteve, të tilla si projektligje, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale, si dhe politika me interes të lartë publik.

Ligji synon transparencën e organeve publike, duke mundësuar dhe nxitur gjithëpërfshirjen e publikut dhe palëve të tjera të interesuara pa asnjë dallim, në procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes me interes të lartë publikë.

Cilat janë projektaktet për të cilat organi publik ka ose jo detyrimin për njoftimin dhe konsultimin publik?

Projektaktet që i nënshtrohen konsultimit janë projekt ligjet, projekt dokumentet strategjike, kombëtare dhe vendore, politikat me interes të lartë publik, të hartuara nga organet publike. Megjithatë, ligji nuk jep një përcaktim tepër të qartë për karakteristikat e projekteve që i nënshtrohen detyrimisht procesit të njoftimit dhe konsultimit publik. Interpretimi më i zgjeruar i dispozitave të këtij ligji përçon idenë se tiparet kryesore që duhet të plotësojnë këto projektakte janë:

së pari, të krijojnë rregulla të përgjithshme sjelljeje, të cilat krijojnë të drejta dhe detyrime për një grup të gjerë personash, dhe/ose;

së dyti, të kenë interes publik. Interesi publik njihet ndryshe si mirëqenia e publikut të gjerë e cila është në kontrast me interesat e një personi apo grupi personash. E gjithë shoqëria ka një pjesë në këtë interes publik, i cili kërkon njohje, promovim dhe mbrojtje nga institucionet publike.

Konsultimi publik sipas këtij ligji nuk zbatohet gjatë procesit të vendimmarrjes që lidhet me çështjet e sigurisë kombëtare, për aq sa ato përbëjnë sekret shtetëror; marrëdhëniet ndërkombëtare dhe marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe; aktet administrative individuale dhe aktet administrative me karakter normativ, përveçse kur me ligj të veçantë parashikohet ndryshe; aktet normative, me fuqinë e ligjit, të miratuara në Këshillin e Ministrave; emergjencën civile; çështjet e tjera përjashtimore të parashikuara me ligj.

Zbatimi i ligjit në praktikë do të jetë një nga udhërrëfyesit më të mirë që do të përcaktojë në mënyrë më të qartë se cilat projekt akte i nënshtrohen detyrimisht konsultimit publik. Megjithatë, në këtë drejtim, vlerësojmë se ka nevojë për një qartësim më të mirë të dispozitave. Deri në këto ndryshime të mirëpritura, është e rëndësishme që grupet e interesit të ushtrojnë presion pozitiv për zbatimin e ligjit dhe ushtrimin e së drejtës për t'u ankuar pranë organeve përgjegjëse dhe më pas në gjykatë.

Kush ka interes të jetë pjesë e konsultimit publik të projektakteve?

Ligji parashikon se personat apo palët që kanë interes të njoftohen dhe konsultohen në hartimin e projektakteve janë:

a) organet publike;

b) shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit;

c) persona fizik të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Shqipëri, si dhe personat juridik të huaj të regjistruar në vendin tonë;

Në kuptim të ligjit nr.146/2014, "grup interesi" është çdo organizatë jofitimprurëse që përfaqëson interesat e një grupi personash fizikë ose juridikë, si dhe persona apo grup personash të tjerë të cilët mund të preken nga projektakti ose kanë interes për projektaktin që i nënshtrohet procesit të konsultimit publik.

Cilat janë të drejtat e personave ose palëve të interesuara për konsultimin publik?

Shtetasit e Republikës së Shqipërisë, grupet e interesit, personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Shqipëri, si dhe personat juridikë të huaj të regjistruar në vendin tonë gëzojnë këto të drejta në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik:

a) të kërkojnë informacion për procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik si dhe të njihen me përmbajtjen e projektaktit.

b) t'i kërkojnë organeve publike që të fillojnë procedurën për hartimin dhe miratimin e projektaktit, nëse ky është publikuar në planin vjetor të procesit vendimmarrës të organeve publike;të shfaqin mendime dhe sugjerime për projektaktin, të cilat duhet t'i bëhen me dije organit publik;

Si mund të marrim dijeni për procesin e konsultimit publik?

Njoftimin për projektaktin për të cilin ne kemi interes duhet ta marrim pa filluar ende hartimi i tyre. Çdo organ publik ka detyrimin që në programet e transparencës, të cilat vijnë si një detyrim i ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të publikojnë gjithashtu planet vjetore që lidhen me procesin e vendimmarrjes. Këto plane duhet të publikohen para se të fillojë procesi i hartimit të projektakteve dhe aty duhet të pasqyrohen nismat që do të ndërmerren në vitin pasardhës.

Pasi projektakti hartohet nga organi publik por ende nuk është miratuar prej tij, ky i fundit ka detyrimin t'i publikojnë projektaktet në një regjistër elektronik, i cili mund të aksesohet/shikohet nga të gjitha palët e interesuara në portalin e internetit në adresën: http://konsultimipublik.gov.al.

Ligji parashikon edhe mënyra të tjera për të informuar/njoftuar palët e interesuara për konsultimin publik, përkatësisht me anë të:

- Postës elektronike (e-mailit);
- Lajmërimit publik, i cili afishohet në ambientet e institucionit që e publikon;
- Lajmërimit në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale;
- Botimit në gazetat lokale ose në dy gazetat më të lexuara në nivel kombëtar.

Çfarë është njoftimi paraprak?

Organi publik, në raste të veçanta, mund të mbledhë informacione dhe/ose opinione paraprake nga grupet e interesit përpara se të nisë procesin e hartimit të aktit përkatës. Çdo palë e interesuar mund t'i përgjigjet njoftimit paraprak brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, duke dorëzuar komente dhe rekomandime të cilat mund t'i vlejnë dhe ta orientojnë organin publik gjatë hartimit të tekstit të këtij projektakti.

Para se të fillojë konsultimi publik, cili është informacioni që duhet të disponojmë?

Personat ose palët që kanë interes për t'u konsultuar për projektaktin, pajisen me informacionin e nevojshëm për t'u krijuar atyre mundësinë të kontribuojnë në mënyrën më efektive të mundshme gjatë procesit

të konsultimit publik. Para se të fillojë konsultimi publik, organi publik nismëtar duhet të informojë palët e interesuara minimalisht për:

- Arsyet përse po ndërmerret nisma dhe ndikimin që ajo do të ketë;
- Afatin, vendin dhe mënyrën me të cilën palët e interesuara mund të dërgojnë mendimet ose rekomandimet e tyre;
- Kontaktet e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik, i cili është përgjegjës për mbledhjen e rekomandimeve;
- Vendin dhe datën e organizimit të takimit publik, kur organi publik vendos ta zhvillojë konsultimin në këtë formë.

Në varësi të kompleksitetit, volumit dhe karakteristikave të tjera të projektaktit, krahas dokumenteve përkatëse, sigurohen shpjegime për qëllimin, problemet që do të trajtohen, idetë e përgjithshme, ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme dhe, për aq sa është e mundur, studime apo analiza që janë kryer për hartimin e projektaktit.

Cilat janë mënyrat dhe afatet për zhvillimin e konsultimit publik në kuptim të ligjit?

Palët e interesuara mund t'i dërgojnë mendimet dhe rekomandimet e tyre brenda një afati prej 20 ditësh pune, nga data e njoftimit paraprak ose nga data e njoftimit dhe konsultimit publik. Ligji nuk e parashikon shprehimisht formën e kërkuar për dërgimin e mendimeve dhe të rekomandimeve.

Megjithatë, forma e shkruar në letër ose në rrugë elektronike e dhënies së kontributit në konsultimin publik garanton më shumë qartësi dhe saktësi të shprehjes së mendimeve nga palët e interesit.

Mënyrë tjetër e konsultimit është nëpërmjet zhvillimit të takimeve publike me palët e interesuara, të cilat organizohen nga organi që harton projektaktin. Është organi publik ai që vlerëson nëse do të zhvillohet apo jo takim publik, rast pas rasti, nisur nga rëndësia që ka projektakti. Palëve të interesuara, të ftuara për të marrë pjesë në takimet publike, u jepet koha e nevojshme për përgatitje. Në çdo rast, ato informohen jo më pak se 20 ditë pune përpara takimit publik, duke u vënë në dispozicion kopje të projektaktit që do të diskutohet. Në çdo takim publik mbahet procesverbal, i cili arkivohet pranë organit publik. Nëse vlerësohet e nevojshme, takimi publik mund të regjistrohet. Procesverbalet dhe regjistrimet e takimeve publike mund të bëhen publike sipas kërkesës së paraqitur, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare.

Në ç'raste mund të zgjatet dhe përsëritet faza e konsultimit publik?

Organi publik, me nismën e tij, mund të vendosë zgjatjen e afatit të konsultimit publik deri në 40 ditë, kur vlerëson se projektaktet janë veçanërisht komplekse ose të rëndësishme.

Organi publik ka të drejtë të zgjasë afatin e dërgimit të komenteve ose mund të ripërsërisë fazën e marrjes së komenteve dhe rekomandimeve kur:

- çmon se nuk është i kënaqur me cilësinë e komenteve;
- me komentet dhe rekomandimet që janë dhënë janë trajtuar çështje të reja, të rëndësishme që nuk kanë qenë pjesë e këshillimit fillestar.

Si duhet të shqyrtohen mendimet dhe rekomandimet e dhëna gjatë konsultimit publik?

Çdo institucion shtetëror cakton një person si koordinator të njoftimit dhe konsultimit publik, i cili bën bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të këtij procesi. Ai është personi përgjegjës për gjithë mbarëvajtjen e njoftimin dhe konsultimin publik, si dhe shërben si pikë kontakti pranë çdo institucioni shtetëror.

Të gjitha rekomandimet grumbullohen nga koordinatori i njoftimit dhe konsultimit publik të organit publik përkatës. Grumbullimi i rekomandimeve bëhet në mënyrë të strukturuar dhe transparente.

I takon organi publik përgjegjës për hartimin e projektaktit të vlerësojë pranimin ose refuzimin e mendimeve dhe rekomandimeve të dhëna nga palët e interesuara të konsultuara. Ajo çka vjen si risi dhe detyrim ligjor në këtë proces është se projektaktet shoqërohen me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuara, sipas dispozitave të këtij ligji.

Nëse rekomandimet e palëve të interesuara nuk janë pranuar, atëherë organi publik paraqet një përmbledhje të arsyeve për mospranimin e tyre në një nga format e njoftimit, të parashikuar në këtë ligj.

Në cilat raste lind e drejta për t'u ankuar për njoftimin dhe konsultimin publik?

Palëve të interesuara i lind e drejta të ankohen nëse organi publik ka cenuar të drejtën e tyre për njoftim dhe konsultim publik, duke mos respektuar një ose më shumë prej detyrimeve të parashikuara në vijim:

a) publikimin në regjistrin elektronik të projektaktit, të njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projektakteve;

b) publikimin në programin e transparencës të planeve vjetore që lidhen me procesin e vendimmarrjes së projektakteve që do të hartohen në vitin/vitet pasardhëse;

c) dhënien e informacionit në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projektaktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar.

d) respektimin e afateve të konsultimit të parashikuara më herët në këtë broshurë;

Kujt duhet t'i ankohemi nëse shkelet e drejta për njoftim dhe konsultim publik?

Ligji parashikon dy mënyra ankimi për të gjitha palët e interesuara që pretendojnë se janë cenuar në ushtrimin e së drejtës për njoftim dhe konsultim publik.

a) Kur projektakti nuk është miratuar ende, ankesa mund të paraqitet pranë titullarit të organit publik përgjegjës për procesin e njoftimit dhe konsultimit publik. Ligji nuk parashikon afate për këtë mënyrë ankimi.

b) Kur projektakti është miratuar, ankesa mund të paraqitet pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të aktit.

Si vepron në rastet e mësipërme organi publik përgjegjës dhe Komisioneri ?

Organi publik përgjegjës, me marrjen e ankesës, merr masa për reflektimin e vërejtjeve të paraqitura, si dhe është i detyruar të njoftojë palën përkatëse të interesuar për këtë reflektim. Po ashtu, ky organ e fton ankuesin të japë komente dhe rekomandime për projektaktin në fjalë.

Komisioneri i kërkon ankuesit dhe organit publik të paraqesin parashtrime me shkrim, brenda 10 ditëve nga marrja e ankesës. Kur e sheh të arsyeshme, Komisioneri mund të organizojë edhe një seancë publike me pjesëmarrjen e palëve të interesuara për këtë proces. Në rast se Komisioneri arrin në përfundimin se ka shkelje të dispozitave të ligjit, ai i propozon organit publik përgjegjës të marrë masat përkatëse administrative sipas legjislacionit për shërbimin civil në fuqi ndaj personit/personave përgjegjës që kanë shkelur dispozitat ligjore për njoftimin dhe konsultimin publik.

A kemi të drejtë të ankohemi në gjykatë ndaj vendimit të organit publik përgjegjës dhe Komisionerit?

Në ndryshim nga ligji për të drejtën e informimit, ligji për njoftimin dhe konsultiin publik nuk parashikon shprehimisht të drejtën e ankimit në gjykatë ndaj vendimit të organit publik përgjegjës apo Komisionerit, në rastet kur ankuesi nuk është dakord me këto vendime.

Megjithatë, në vlerësimin tonë e drejta e ankimit në gjykatë nuk duhet të kufizohet pasi është e parashikuar në ligjin nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Përkatësisht në nenin 15, gërma “a” të këtij ligji parashikohet se gëzon të drejtën e padisë në gjykatat administrative, “çdo subjekt, që pretendon se i është cenuar një e

drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik”. Afati për atë kundërshtuar në gjykatën administrative, vendimin e organit publik përgjegjës ose të Komisionerit ose mosveprimin e këtyre institucioneve në rastet kur j’u është drejtuar një ankesë është brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të vendimit (aktit administrativ) ose nga data e mbarimit të afatit ligjor për nxjerrjen e aktit administrativ ose e afatit për shqyrtimin e tij, në rastet e mosveprimit të organit publik përgjegjës apo Komisionerit.

Si mund t’ju vijë në ndihmë Komiteti Shqiptar i Helsinkit për zbatimin e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik?

KShH ofron shërbime ligjore falas për çdo grup interesi (shoqatë biznesi, organizata jofitimprurëse, përfaqësues të medias ose çdo grupim tjetër qytetar që mbron një interes publik), në rastet kur janë shkelur procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të parashikuara në ligjin 146/2014. Në paketën e shërbimeve ligjore falas përfshihet:

a) Konsulencë ligjore nëpërmjet informimit të grupeve të interesit për mjetet dhe mënyrat e ankimit si dhe për të shpjeguar dispozita të ndryshme të ligjit;

b) Asistencë në plotësimin e kërkesës ankimore që paraqitet pranë titullarit të organit publik përgjegjës dhe/ose Komisionerit;

c) Përfaqësim në procedurat administrative që zhvillohen për shqyrtimin e ankesës nga titullari i organit publik përgjegjës dhe/ose Komisioneri;

d) Asistencë në përgatitjen e padisë dhe përfaqësimin e çështjes në gjykatën administrative nëse ushtrohet e drejta e ankimit në gjykatë;



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Rr. “Brigada e VIII”, Pallati “Tekno Projekt”, Shk. 2, Ap. 10, Kati 6.
Kutia Postare 1752

+ 355 4 223 3671

+ 355 68 20 23 699 / +355 69 40 75 732

office@ahc.org.al

www.ahc.org.al

Komiteti Shqiptar i Helsinkit